



Raporti i Tubimit me Publikun për gjashtëmujaorin e parë të aktiviteteve të Komunës



Komuna e Drenasit

Raporti i Tubimit me Publikun

- Në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit është mbajtur Tubim me Publikun lidhur me informimin e pjesëmarrësve për aktivitetin e Komunës për gjashtëmuorin e parë të këtij viti, të arriturat, vështirësitë dhe synimet.
- Këtë takim e udhëheqi Bekim Dobra, shëf i Zyrës për Komunikim me Publikun në Komunën e Drenasit i cili njoftoi të pranishmit për arsyet e takimit si dhe të drejtat e pjesëmarrësve gjatë kërkesave, vërejtjeve, sygjërimeve, ankesave të ndryshme që mund të kenë ata për aktivitetet komunale që kanë përfunduar apo që janë në proces por edhe ato që do të duhej të futen në buxhetin e ardhshëm.
- Pjesëmarrës në këtë takim ishte nënkryetari i Komunës së Drenasit, Arben Shala, drejtorë të drejtorive komunale në Komunën e Drenasit, përfaqësues dhe administratorë të fshatrave etj.
- U diskutuan shumë projekte, projekte që janë në proces e sipër, projekte që do të duhej të futen në projeksiione buxhetore, projektet me me prioritet për qytetarët e vendbanimeve përkatëse etj.
- Ky tubim me publikun vjen pas përfundimit të fazës së parë të dëgjimeve buxhetore me publikun që u kryen ditë më parë nëpër gjitha bashkësitë lokale të Komunës së Drenasit.



GLOBG06 MUNICIPALITY			
Pranliar	09.08	2022	
Nj. Oty	Numer	Shupcs	Vlera
0A-052101	41545		

Komuna e Drenasit

Raporti i Tubimit me Publikun

- Tubimin e hapi Bekim Dobra – Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun ku pasi përshëndeti të pranishmit, njoftoi ata për njoftimet publike dy javë para takimit nëpërmjet shpalljeve publike të vendosura në hyrje të Komunës, webfaqen e Komunës së Drenasit, faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook për mbajtjen e Tubimit me Publikut.



Raporti i Tubimit me Publikun

- Tubimi ka karakterin informues ku përfaqësuesit komunal informojnë qytetarët për të arriturat në gjashtë mujorin e parë të këtij viti fiskal, për të arriturat dhe vështirësitë, synimet dhe investimet kapitale gjatë pjesës së dytë të këtij viti. Ndërsa ju të pranishëm mund të bëni pyetje dhe të jepni propozime përfaqësuesëve komunal lidhur me realizimin e projekteve që janë të planifikuara për këtë vit dhe çështje të tjera që janë në interes për ju si qytetarë të Drenasit.

Raporti i Tubimit me Publikun

Arben Shala – Nënkrjetar i Komunës së Drenasit

Të nderuar të pranishëm, i nderuar asamblist zotëri Haxhiu, të nderuar qytetarë, faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë tubim publik.

Ndonëse vitin e kaluar e kemi kaluar me shumë sfida edhe këtë vit lufta në Ukrainë ka krijuar sfida tjera të shumta, megjithatë përkundër shumë sfidave, rritjes enorme të çmimeve, jofunksionalitetit të OSHP-së që po ndikojnë seriozisht në punën tonë, ne me të gjitha kapacitetet jemi munduar të realizojmë të gjitha projektet që janë miratuar në kuadër të buxhetit komunal. Falenderojmë të gjithë qytetarët që na kanë mirëkuptuar dhe ndihmuar në realizimin e projekteve, falenderojmë edhe disa nga administratorët e fshatrave që janë të pranishëm këtu, që kanë bashkëpunuar me ne pa kursyer për të mirën e përbashkët. Gjysma parë e këtij viti na solli lajme të mira për Komunën tonë. Komuna jonë zuri vendin e tretë në garë për performancë komunale dhe me këtë përfitojë grantin mbi 900 mijë euro, të cilat do të shfrytëzohen për realizimin e projekteve për të mirën e gjithë komunitetit.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun

Arben Shala – Nënkrjetar i Komunës së Drenasit



Gjithashtu mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal u miratua Harta Zonale e cila i hap rrugë zhvillimit të planifikuar të qytetit dhe e treta ka të bëjë me raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit ku opinioni i ZKA-së është një ndër opinionet më të mira të mundshme për Komunën tonë, për pasqyrat financiare. Është nderuar të pranishëm për shkak të ngritjes së çmimeve gjatë kësaj periudhe që po raportojmë, sidomos në sektorin e ndërtimit, intensiteti i realizimit të kontratave dyvjeqare të lidhura më 2021 ka qenë i ulët. Për shkak të rrethanave të lartcekura jemi në proces të prokurimit të shumë projekteve infrastrukturore për asfaltim, ndriçim, kanalizime, etj. Duhet theksuar që shumë projekte për shkak të qasjes selektive të nivelit qendror, janë hequr apo janë ngrirë nga buxheti i sivjetëm si : Ndërtimi i kapaciteteve për ujë të pijshëm, me theks të veçantë ndërtimi i liqenit të Vërbovcit, vazhdimi i ndërtimit të rrugës me katër korsi, Gllobar – Komoran, problemet që dalin nga përkujdesja dhe mirëmbajtja e objekteve sportive dhe kulturore, parku i biznesit dhe kërkesa për ndërtimin e stadiumit nacional, ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së, ndërtimi i Pishinës Gjysëmolympike.

Ndërsa sfidat që mbesin dhe janë kronike, për të cilat ne si Komunë kemi ngritur zërin gjithmonë janë : Gjetja e zgjidhjes për pagesë për detyrimet që dalin nga kontratat kolektive, trajtimi i ujërave të zeza, zgjidhja e pronave që janë nën komasacion, problemet me kompaninë Rajonale të Mbeturinave, rishikimi i ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, problem me qenët endacak. Në fushën e shëndetësisë tashmë ka përfunduar renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve dhe jemi të orientuar drejt përmirësimit të cilësive në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor me qëllim që ofrimi i shërbimeve të jetë sa më afër qytetarit. Ndërsa në fushën e arsimit po vazhdojnë investimet në efikasitet të objekteve shkollore dhe për furnizimin me kabinete të informatikes dhe laboratorike. Fëmijët dhe të rinjtë tanë përfitojnë nga trajnimet, kurset dhe aktivitetet tjera Rinore të organizuara nga “Flutura Academy” pa pagesë. Po vazhdojmë me përkrahjen e fermerëve në bashkëpunim me Islamic Relief për rritjen e numrit të serave dhe për ujitje.

Komuna e Drenasit

Raporti i Tubimit me Publikun

Samedin Kiçina (përfaqësues i fshatit Baicë)

- Nuk është që nuk është punuar në Baicë por kërkesa kemi të mëdha prap, jemi mbrapa shumë në infrastrukturë. I pash disa që janë hy në projekt me u punu por ka ende disa nevoja. Rruga mbi rampë “Zeqir Kiçina” është në gjendje të rëndë. Rruga “Petrit Kiçina” është tek Kiçinët, janë dy lagje që i lidhë e njëjta rrugë, janë 300 metra gjatësi.
- Drejtorit të Arsimit ja kisha bërë një kërkesë nëse ka mundësi për transport të nxënësve sepse jemi mbetur në dy shkolla, është liruar shumë hapsira, tri klasë po mbesin të thata sepse disa nxënës po shkojnë në shkollë tjetër, kisha pas qef me u kry qekjo punë me i kthi nxënësit në shkollën e tyre. Kisha pas dëshirë që tek rampa të bëhet një rreth se po ka aksidente sepse është shumë e ngushtë. Ju kërkojë falje, faleminderit për kohën, presim përgjigje.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun

**Arben Shala – Nënkyetar i Komunës
së Drenasit**

- Faleminderit Samedin, disa nga kërkesat i kemi marrë në dëgjimet buxhetore dhe do të trajtohen. Për qështje të arsimit më mirë me dhanë përgjigje drejtori Gjoka.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun

Muhamet Gjoka – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Drenasit

Përshëndetje për të gjithë, duhet të ju informojë se transporti i nxënësve është i rregulluar me ligj dhe është e cekur distanca prej së cilës obligohen institucionet me kry transportin. Distanca është 4 km, por për informatën tuaj është duke u punuar nga ministria për rrjetizimin e shkollave sepse fshatrat po boshatisen. Unë jam në grup punues në nivel të Ministrisë së Arsimit. Duhet me pa këtë pjesë sepse jo që mungojnë mjetet por e kemi të definuar distancën mbi 4 km. Kemi kërkuar që me pas përjashtime aty ku ka rrezikshmëri, tek rrugët me katër korsi që të bëhet një zgjidhje por që na është kërkuar të priten ato ndryshime që priten me ndodh në aspektin ligjor nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun

Afrim Gjeli – (përfaqësues i fshatit Poklek i Ri)

- Sikurse vendet tjera edhe Pokleku i Ri ka kërkesat e veta, një ndër to është edhe legalizimi i pronave që ka disa ndërtesa, nuk kanë leje sepse nuk është bërë pranimi teknik i tyre sepse në të ardhmen ndikon në hartimin e planeve të ndryshme sikurse planet operative emergjente, në qoftë se e kemi të legalizuar nuk e di qysh me vepru. Ka kërkesa për ndriqim public. I kam adresuar ato kërkesa por si kam me numër protokoli. Disa kërkesa për asfaltime të rrugëve jo distanca të mëdha. Për qenët endacak është shqetësim i madh për banorët. Problemi i shpejtësisë së madhe ndoshta me ndonjë polic të shtrirë sepse paraqet rrezik të madh për banorët. Disa kërkesa që kanë qenë në të kaluar janë realizuar por ka ende si ajo e varrezave për rrethojën e saj por nuk është ende pronë publike dhe e ka ndalu atë proces, por të paktën një rrugë me rregullu për tek varrezat me zhavor apo me ndonjë mundësi tjetër sa e lejon ligji. Kërkesa tjera nuk kam përveç atyre që i kam protokoluar, presim të realizohen ato projekte sepse janë bërë kërkesa në bazë të prioriteteve të banorëve.



Raporti i Tubimit me Publikun

Arben Shala – Nënkryetar i Komunës së Drenasit

- Faleminderit shumë Afrim, po është e vërtetë që qështja e legalizimit të pronave është shumë e rëndësishme por po besojë që na jep sqarim drejtoresha në fjalë pas përfundimit të fjalimit tim. Ndriçimi sipas gjitha parashikimeve sic e kemi cekur do të kryhet në gjitha lokacionet në Komunën e Drenasit, normalisht aty ku ka shtylla betoni. Sa i përket qështjes së qenëve endacak është e rëndësishme dhe ne si Komunë kemi marrë iniciativa të ndryshme, kemi memorandum me një organizatë nga Zvicra që bëhet kastrimi i tyre. Për policët e shtrirë nuk parashihet të ketë polic të shtrirë përkundrazi do të hiqen të gjitha aty ku ka trotuare sepse është e kufizuar shpejtësia me shenja të trafikut.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun

Lumnije Gjoshi – Krapi – Drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Komunën e Drenasit

- Përshëndetje për të gjithë, atëherë sa i përketë shqetësimeve rreth qenëve endacak ne kemi lidhur memorandum bashkëpunimi me një fondacion zvicëran, me pronar Shaban Mehmeti, njoftimin e kemi bërë në faqen e Komunës dhe në Policinë e Kosovës që qytetarët mund të thërrasin tek operatori ose tek drejtoria jonë që të ja përcjellim operatorit që kemi kontratë me ta. Sa i përketë policëve të shtrirë, tash edhe me rregullore e kemi të ndaluar vendosjen e tyre, por me verifikimin e gjendjes në terren nga inxhinieri kompentent e vendosim kufizimin e shpejtësisë, por mund të ketë kërkesa edhe nga banorët për policinë të ketë inspektime për shpejtësinë e madhe që zhvillohet.



Raporti i Tubimit me Publikun

Zekë Kluna – (përfaqësues i fshatit Poklek)

- Unë i kam disa kërkesa për fshatin Poklek por ende nuk janë realizu. Janë disa indikacione që ka fillu diçka, ka një dritë në fund të tunelit, ka filluar uji i gazuar me u rregullu sepse pa ujë nuk ka jetë. Jemi duke pasur problem me mbeturinat sepse kompania nuk po mbledhë mbeturinat dhe jemi të detyruar që poqëse nuk ndërmerren masa të marrim mbeturinat e të ja vendosim kompanisë para hyrjes së tyre. Kam vërejtje tek uji, kanalizimet që janë kryer më herët janë shpluar gypat, nuk më intereson kush ka qenë kryetar më herët por unë nuk lejojë punime shkel e shko. Varrezat po du me u rregullu se edhe vet ka me shku aty me pushu. Vetëm Besim Tahiraj ja ka nisur me ma kry një punë qysh duhet tjerët jo. Asfaltin jo, Endriti nuk qenka këtu. Edhe për varreza po thotë Afrimi është tokë e Poklekut të Ri por vetëm e Poklekut, nuk ka Poklek të ri e të vjetër.



Raporti i Tubimit me Publikun

Arben Shala – Nënkrjetar i Komunës së Drenasit

- Faleminderit Zekë, nga unë e gëzon respektin maksimal. Nga një raport që kam këtu kanë kalu në projekt ose janë aprovu asfaltime dhe kanalizime. Sa i përketë mbeturinave e kemi një problem kronik që po na përcjell, por është kompani Rajonale, i kemi fituar dy kamionë dhe do ja dhurojmë kompanisë rajonale “Pastrimi” që të kryej shërbime më cilësore për qytetarët. Rregullimet administrative janë të rregulluar me ligj dhe nuk kem çfarë të diskutojmë, është në proces, sugjerimet tua do të merren parasysh.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun


Bekim Dobra pasi konfirmoi se nuk ka pyetje të tjera, shpalli të mbyllur takimin e Tubimit me Publikun.

Komuna e Drenasit



Raporti i Tubimit me Publikun




Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit


Shyqiri Bublaku
Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa


Ardyl Mziu
Zëdhënës i Komunës

Drenas,
27.06.2022